

## PROBLEMATIKA E PROJEKTEVE ME FINANCIME TË HUAJA

nga Artan TOPJANA<sup>1</sup> – Auditues i Lartë,

botuar në gazetën “Koha Jonë”, më 03 shkurt 2015.



Disa nga veprat më të mëdha publike në vendin tonë, financohen nëpërmjet kredive, huave apo grandeve, të cilat garantohen nga shteti. Menaxhimi i projekteve me financime të huaja bëhet nëpërmjet krijimit të njëjësive të koordinimit, menaxhimit apo zbatimit të projekteve, por edhe të institucioneve në rolin e agjencisë së ekzekutimit të projektit, kjo e fundit më shumë në rastet e rikonstruksionit apo ndërtimit të rrjeteve të ujit të pijshëm. Në përgjithësi, disbursimi i fondeve, menaxhimi financiar, metodat e prokurimit dhe kushtet e kontratave, bazohen në udhëzuesit e institucioneve financiare kredidhënëse. KLSH, bazuar në standardet e auditimit dhe vlerësimin e riskut, përzgjedh dhe auditon aktivitetin e projekteve si në aspektin e zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, ashtu edhe në aspektin vlerësues apo të performancës, i cili ka të bëjë me arritjen e objektivave të përcaktuara. Nga auditimi i tyre ka rezultuar se, projektet shoqërohen me vonesa të shumta si pasojë e të cilave kostoja e projektit rritet mbi atë të

parashikuar dhe marrja e përfitimeve nuk bëhet në sasinë dhe kohën e parashikuar, pra me mungesë të ardhurash nga investimi.

Këto vonesa kryesisht vijnë nga procesi i shpronësimeve. Bllokime të shumta të punimeve bëhen sidomos në akset rrugore, si pasojë e mos arritjes së realizimit të shpronësimit për interes publik. Banuesit në zonat që shpronësohen edhe pse janë pronarë, nuk arrijnë ta vërtetojnë pronën me dokumentacionin ligjor të domosdoshëm për t'u shpronësuar sipas ligjit. Çdo vonesë shoqërohet me pretendime nga ana e kontraktorëve, të cilat përkthehen në detyrime financiare, rrjedhimisht rritje të vlerës së kontratave, pa marrë në konsideratë faktin se këto vonesa ndikojnë në vënien në afatin e parashikuar në eficiencë të projektit. Vonesat në përfundimin në afat të kontratave, sidomos përtej afatit 18 mujor siç edhe ka ndodhur në shumë projekte, shoqërohen me rishikimin e çmimeve. Bazuar në inflacionin e vendit tonë dhe të vendit nga i cili vjen kontraktori, sipas një formule bëhen përlllogaritjet dhe në përgjithësi rezulton me rritje të vlerës së kontratës më tej të projektit.

Vonesa të shumta vijnë si pasojë e ndryshimeve të projekteve. Në shumë raste projekt zbatimet nga koha e hartimit deri në kohën e zbatimit të tyre, kalojnë një periudhë që shkon edhe deri në 10 vite. Për periudha të tilla, gjendja e objekteve, terrenit, zhvillimit të territorit etj., ndryshojnë dukshëm dhe për këtë arsye kërkohet rishikimi i tyre. Rishikimi i projekt zbatimeve shoqërohet me kosto shtesë jo vetëm sa i përket shërbimeve këshillimore, por edhe sa i përket zërave të rinj të punimeve të cilët nuk janë pjesë e preventivave. Çdo zë punimi i cili nuk është pjesë e preventivit origjinal të përfshirë në procesin e prokurimit, prokurohet në gara të vogla dhe në asnjë

rast nuk pritet të përfitohen çmime si në garat e mëdha, siç është prokurimi i kontratave. Si pasojë e mangësive të mësipërme vetëm nga ky fenomen, kostot e projekteve janë rritur aq shumë, sa në ndonjë rast edhe deri në 5 % të vlerës së projektit.

Projektet e zbatimit hartohen pa parashikuar siç duhet infrastrukturën ekzistuese që intersekon projektin, kryesisht në ndërtimin e segmenteve rrugore. Pothuajse të gjitha projektet e audituara nga KLSH, kanë rezultuar me këtë problem. Në rastin e hartimit të një projekti të saktë, ku përcaktohen punimet për zhvendosje të rrjetit të energjisë elektrike, telefonie, ujësjellës kanalizime etj., çmimet e përfituara nga prokurimi i kontratës bazë, sigurisht që do të jenë më të favorshme, se sa në rastin e realizimit të këtyre punimeve nëpërmjet procedurave të reduktuar siç është parashikuar rëndom në zbatimin e këtyre projekteve.

Ndryshimet e projekteve, në ndonjë rast kanë rezultuar deri në 70 % të zbatimit, jo vetëm sa i përket shtrirjes, por edhe veprave të artit, siç mund të përmendim segmentin rrugor Damës-Tepelenë. Ndryshime të projekteve me pasoja financiare ka pasur edhe në segmentin rrugore Levan-Vlorë, Tiranë-Elbasan, Kalimash-Rexhepaj, etj. Ndryshim i vijës së projektit, kryesisht në ndërtimin e rrugëve shoqërohet me listë të re shpronësimesh, ndryshim të volumit të punimeve etj. Raste të tilla vijnë edhe si pasojë e mos rakordimit të institucioneve shtetërore në lidhje me investimet që ato programojnë dhe zbatojnë. Për shembull, një hidrocentral në ndërtim parashikon një kuotë të liqenit, sipas së cilës përmythen tre kilometër rrugë, e cila është po në ndërtim. Lind pyetja, duhet të ndryshohet projekti i hidrocentralit apo i rrugës? Cilido ndryshim qoftë, është e sigurt se do të rritet kosto e projektit.

Një segment rrugor i ndërtuar sipas një projekti, afektohet nga një projekt tjetër për furnizimin me ujë. Pas ndërtimit të shtresave rrugore, madje edhe ato asfaltike, bëhen ndërhyrje duke i dëmtuar këto shtresa për futjen e tubacioneve të ujit të pijshëm. Këto fenomene mund të ndodhin në diferencë kohe, por kur ndodh që shtresat të dëmtohen një muaj pas ndërtimit, kemi të bëjmë me një kosto për të cilën është vështirë të përcaktohet edhe përgjegjësia. Papërgjegjshmëria në hartimin e projekteve arrin deri aty sa hartimi i projekteve për dy segmente rrugore që bashkohen me njëri tjetrin, gjatë zbatimit rezulton se kanë diferencë të dukshme në kuotë. Ka pasur raste ku një gjatësi rruge mbi 150 m, është mbuluar me shtresa të reja për të arritur kuotat përkatëse dhe sigurimin e kushteve për qarkullim normal.

Kosto e projektit rritet edhe si pasojë e ndryshimeve ligjore. Për shembull, si pasojë e ndryshimeve nga rishikimi i kodit rrugor, në disa projekte rrugore është kërkuar shtesë financimi, si pasojë e ndryshimit të standardeve të sinjalistikës horizontale dhe vertikale, të cilat në rast se do të ishin prokuruar me këtë ndryshim, nuk do të kishte një humbje të tillë.

Vonesat e shumta të projekteve shoqërohen me shtesa në kontratat e mbikëqyrjes së punimeve, rrjedhimisht në rritje të kostos. Për çdo zgjatje të afatit të përfundimit të punimeve sipas një projekti të caktuar, rrjedhimisht do të nevojitet zgjatja e kontratës për shërbime konsulente. Nuk ka një përcaktim të prerë cili rast është më i favorshëm, prokurimi i shërbimeve konsulente me çmime të fiksuara apo siç aplikohet në përgjithësi, me kohë bazë shërbimi, por në projektet me financime të huaja metoda më e aplikuar

është e dyta. Pavarësisht më sipër, rritje të kostos së projekteve në këtë rast kemi edhe si pasojë e rritjes së tarifës së angazhimit.

Projektet me financime të huaja shpesh herë nuk kanë kthyer as vlerën e investimit. Ndërtohen tregje të cilët nuk janë vënë në përdorim asnjëherë. Si një rast konkret mund të përmenden tregjet rajonale të fruta-perimeve. Ndërtohen impiante të trajtimit të ujërave të zeza, por nuk vihen në funksionim. Ndërtohen impiante për eliminimin e gazrave të rrezikshëm por nuk vihen në përdorim, etj., siç mund të përmendim atë të ndërtuar në landfillin e Sharrës Tiranë. Pothuajse për asnjë projekt me financim të huaj si për shkak të problematikave të mësipërme, ashtu edhe për të tjera arsye, nuk janë realizuar objektivat në kohën e parashikuar. Madje për shumë projekte objektivat përcaktohen të pa qarta dhe të pamatshme, sa është vështirë të vërtetohet dhe të përlogaritet përfitimi i pritshëm nga investimi.

Përmirësimi i identifikimit, realizimi i fizibilitetit, projektimit, prokurimit, zbatimit, raportimit dhe monitorimit të këtyre projekteve në përputhje me legjislacionin vendas dhe të huaj, ngelet një sfidë për të ardhmen. Rritja e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit të tyre, duhet të jetë në vëmendjen e duhur të institucioneve, duke parë projektet me financime të huaja si një mjet i domosdoshëm dhe shumë i rëndësishëm në zhvillimin e vendit.

---

<sup>1</sup> *Shkrime të tjera të botuara nga Artan TOPJANA për periudhën janar-qershor 2015:*

- *Projekte me objektiva të qarta, garanci për mbarëvajtjen e tyre.  
(Botuar në gazetën "Tirana Observer", më 9 maj 2015.)*